



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7283
Data: 04.09.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME FERMERËT PËR DRAFT
BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i gjashtë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **13.08.2025**, duke filluar nga ora **10:00** në në **Sallën e Takimeve**, e cila gjendet në katin e parë të objektit të Komunës së Hanit të Elezit, ku morën pjesë gjithsej 31 persona, prej tyre 4 gra dhe 27 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z. Sevdin Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj. Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z. Sevdin Dernjani**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
- 2. Diskutimi**

Sevdin Dernjani thekson: Keni parasysh se qëllimi kryesor i këtij takimi është t'i dëgjojmë kërkesat apo rekomandimet tuaja të cilat i keni lidhur me projektet apo edhe subvencionet që janë të parapara për vitin 2026. Buxheti total për vitin 2026 është 4.2 milion €, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, investimet apo mallërat dhe shërbimet. Prej shumës totale, buxheti është i ndarë në grandin e përgjithshëm me shumë në përqindje 44% , grandin specifik i arsimit përshin 34%, grandin specifik i shëndetësisë përfshin 14% , si dhe të hyrat vetanake përfshijnë 8%. Nd1% rkaq, konkretisht te Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural janë planifikuar rreth 30 mijë € për subvencione. Pa e zgjatur më shumë, do t'ia kaloj fjalën drejtoreshën për prezantim më të hollësishëm.

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor nga radhët e fermerëve.)

Lindita Ballazhi thekson: Jemi në fazën e planifikimit final buxhetor, pasi që faza fillestare ka qenë gjatë muajit qershor, ku ne i kemi marrë të gjitha propozimet nga çdo qytetar që ka marrë pjesë nëpër ato dëgjime fillestare buxhetore. Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, normalisht duke e pasur parasysh këtë buxhet fillimisht janë planifikuar kategoritë buxhetore Paga dhe mëditje e cila përfshin mbi 60% të buxhetit total, më pas pjesa e mbetur është planifikuar në kategoritë e tjera buxhetore, ku prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes kemi fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. Ajo çfarë ia vlen të theksohet është se për vitin 2026 është një rritje e subvencioneve, ku për vitin 2026 pritet të jenë 185 mijë euro subvencione, apo rreth 42 mijë euro më shumë se viti aktual, dhe normalisht kjo shumë mund të rritet edhe më shumë si kategori buxhetore. Për detaje mbi buxhetin e planifikuar që ndërlidhen me Drejtorinë e Bujqësisë, besoj se drejtori përkatës do të mund të ju japë më shumë detaje. Nëse kemi ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse kemi ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Abduraman Bushi (drejtor i DBPZHR): Sot ju kemi thirr në takim lidhur me buxhetin komunal, dhe jo vetëm për vitin e ardhshëm, por edhe që të ju prezantoj me planin afatgjatë për 4 vitet e ardhshme, ku sot do të mund të jepni propozimet tuaja dhe kërkesat tuaja dhe në bazë të tyre edhe do të bëhen planifikimet. Unë si drejtor për vitin e ardhshëm kam paraparë 30 mijë euro, ndërsa këtë drejtori kur e kam marrë, e kam gjetur me buxhet të planifikuar vetëm 11,500 € në subvencione, ndërsa disponimi i kryetarit dhe i imi ka qenë që buxheti të rritet në bazë të kërkesave të shumta dhe të nevojshme tuajat, he tani jemi rreth 20 mijë € më shumë se sa vitin e parë kur kam marrë në menaxhim drejtorinë. Nëse unë do të vazhdoj të jem drejtor i DBPZHR-së, synimi im që pas katër viteve të mos shoh më asnjë fermerë duke punuar fizikisht. Ia kemi filluar edhe vitin e kaluar, edhe sivjet i kemi rreth 30 mijë euro duke përkrahur fermerët me pajisje bujqësore të mdhaja, gjithashtu edhe me multikultivaor me freza në abshkëpunim me LAB-in. Pra diku 50 mijë euro jemi duke i ndarë vetëm sivjet për pajisje bujqësore për fermerët. Ndërsa sot, ju lutem që të shprehni çdo mendim, çdo propozim apo çdo kërkesë tuajën që ta kemi si orientim në planifikimet tona buxhetore.

Kushtrim Loki: Unë përfaqësoj pjesën e bletarisë. Po e shoh që buxheti për DBPZHR u rrit në krahasim me vitin e kaluar, ku ka qenë 19 mijë euro, ndërsa tash është 30 mijë €, kjo është gjë e mirë, por jo e mjaftueshme. Drejtori e përmeni që është duke u investu gjithë e më shumë mundësinë e zhvillimit të teknologjisë dhe përdorimin e saj në bujqësi dhe digastere tjera. Por shpresoj se duke pasur rishikime të buxhetit me tentu me e rrit buxhetin, nëpërmjet grandeve dhe subvencioneve, si prej organizatave të huaja por edhe ato qeveritare. Përveç bujqësisë, në Han të Elezit ka edhe kultura tjera apo sektorë tjerë që mundën me u përkrah edhe ma shumë, si blegtoria, bletaria, pylltarinë, etj, dhe që mendoj se janë goxha të kultivume.

Sevdi Dernjani: Është e kuptueshme se për sektorin e DBPZHR edhe kjo rritje e buxhetit nuk mund të jetë e mjaftueshme sepse kërkesat dhe mbulueshmëria e të gjitha nevojave është e madhe, megjithatë së paku vit pas viti tentohet rritje e tij, vitin e kalim 19 mijë €, e sivjet 11 mijë më shumë. Gjithsesi, bashkë me drejtorin ne kemi shku edhe në nivel qendror por edhe prej organizatave të ndryshme, si TIC apo Qatar Charity, apo Islamic Relief, ku kemi parashtrur kërkesa dhe projekte konkrete, por që diku kemi arritë me pas mbështetje, e diku jo.

Muhamed Suma: Jam nga fshati Dimcë, fermer i sektorit të bletarisë. Është me u përgëzu komuna që ka fillu me e kuptu rëndësinë e sektorit që mbulojnë fermerët, dhe kjo shihet edhe te planifikimet ku vitete e fundit shihet se për çdo vit ka pas ngritje të buxhetit të planifikuar për këtë drejtim. Unë kam marrë pjesë edhe në dëgjime të ma hershme e në veçanti në ato të dedikuara për fermerët dhe në bazë të kësaj unë kam dy pyetje dhe tre propozime:

1. Sa prej propozimeve që fermerët i kanë dhënë në debatet e kaluara janë futur në listën e buxhetit final dhe janë realizuar ato si kërkesa që dalin nga fermerët?
2. Në shumën e ndarë prej 30 mijë euro për vitin e ardhshëm, në çka jeni bazu në ndarjen e fiks kësaj shume?
3. Propozoj që fermerët e bletarisë me u mbështetë ashtu siç janë mbështetë deri tash, me pajisje apo me trajnime e ligjërata të ndryshme.
4. Propozoj që me u hap rrugët e thella rurale, në fshatra ma larg, shembull është Kreveniku, Dremjaku, Dimca ku relievi ndryshon, dhe në shumë vende që duhen me u lëviz bletët, dhe në këtë kohë të nxehtë, bjeshka ku i mbajmë bletët nuk është si ma herët, tashduhet patjetër me i lëviz dhe duhen hap rrugët ma t' thella për me i dërgu aty ku duam.
5. Propozoj që duke u bazu që ka fillu nga niveli qendror subvencionimi me disa lloje të bimëve apo luleve, dhe nëse bëhet kjo edhe nga niveli lokal do të ishte mirë sepse fermeri duhet me i mbjellë për bletët e veta dhe pse mos me mbjellë diçka në tokat që i kemi, përveç kulturave bujqësore me gru e misër, unë kam mbjellë diku rreth 1.5 hektarë por pse mos me mbjellë edhe ma shumë në tokat që posedojmë.

Sevdi Dernjani: Lidhur me propozimet apo me ato që i listove, shembull lidhur me rrugët në fshatra, e kemi rastin konkret për rrugën Gorancë – Krivenik, që lidh dy fshatrat, e që është investim i madh prej 1.1 milion euro. Shtrimi i kësaj rruge ka me mundësu që shumë toka andej me u punu dhe u zhvillu kulturat bujqësore, janë pak procedurat që mund të zgajsin deri në finalizim të rrugës, mirëpo rezultati do të jetë i kënaqshëm edhe me ndikimin e saj tek zhvillimi bujqësor. Gjithashtu është edhe rruga që është shtrur prej Kroit të fshatit Paldenicë deri te Ramuktë, ku mundëson zhvillimin e tokave në atë pjesë. Ndërsa për vitin e ardhshëm, është haprturoprojekti i rrugës prej Vërtomicës deri te pishat nalt në Neçavc.

Abduraman Bushi: Ashtu qysh e thash edhe ma herët, synim i jem është që fermerët du me i pajis të gjithë me pajisje bujqësore. Këto 30 mijë euro të gjitha do të jenë për pajisje bujqësore, dhe nëse dalin për të gjithë fermerët, do të vazhdoj edhe vitin tjetër planifikim i buxhetit vetëm për pajisje bujqësore. Kjo shumë është pak a shumë ajo që kam mendu që është e mjaftueshme si rritje, edhe pse kjo s' do të thotë që janë vetëm kaq, sepse do të ketë përkrahje nga zyra e kryetarit, nga donacione, bashkëpunime etj. Pra, unë synoj që investimet të jenë vetëm për pajisje bujqësore, mirëpo nëse ju keni mendim ndryshe, ne edhe i ndryshojmë synimet.

Lindita Ballazhi: Lidhur me pyetjen se sa prej propozimeve tuaja kanë hyrë në buxhet, ku ju njoftoj se të gjitha kërkesat apo propozimet në dëgjimet e para në qershor, ne i kemi shënuar në një raport, ku shënohet emri dhe mbiemri i propozuesit, si dhe statusi i kërkesës së tij, pra çdo kërkuese ne i ekmi kthyer një përgjigje ka hyrë apo nuk kanë hyrë në buxhet dhe arsyen për përgjigjen, sepse ka disa kërkesa që nuk varet nga vullneti apo buxheti i komunës, por sepse nuk janë në kompetencë të komunës. Nuk di për momentin se a ka pas propozime nga fermerët në dëgjimet e pra, por mund të them se shumica e propozimeve janë futur në buxhet dhe janë të realizueshme.

Muhamed Suma: Sa i përket projekteve, ka qenë një kërkesë prej bletarëve që me u pajis me tel elektrik, dhe ajo kërkesë është realizuar, gjë për të cilën ju falënderojmë që është marrë parasysh si kërkesë. Ndërsa te hapja e rrugëve rurale, shumë mirë është bo rruga te Ramuktë, gjithashtu edhe për rrugën Gorancë – Krevenik që ka me ndihmu shumë. Por unë e kam për ato vende më të thella, shembull është një rrugë prej Dremjak – Llokme, ku s'është patjetër me u shtru me asfalt apo kubëza, mjafton me u hap si trase sa me kalu mjetet tona, dhe e dyta prej Krevenikut te Mullinjtë, është një rrugë rreth 1km.

Hajrulla Kalisi: Jam fermer i perimkulturës, përfaqësoj serrat e mdhaja të larta, dhe deshta me dit se për çka na keni anashkalu neve për subvencionim për serra?

Abduraman Bushi: Arsyeja që ne i kemi “anashkalu” perimkulturën është se një pjesë e juaja përfiton shumë, e një pjesë përfiton pak. Ne kur i qesim njoftimet, nuk mundemi dikujt me ia dhanë subvencione shembull 10 mijë € e dikujt 2 mijë euro, e mandej me u kriju përçamje, dhe për momentin kemi vendos që këto kultura për subvencionim me i ndalë dhe me u fokusu te subvencionet që janë më të barabarta për kultura tjera bujqësore. Por kjo s'do të thotë se do të vazhdojë kështu, me rritjen e buxhetit tek DBPZHR do të ketë hapësirë për subvencionim të sektorëve të ndryshëm.

Hajrulla Kalisi: Menoj që s'ka rëndësi se sa është përfitimi e me lidh me subvencionimin. Këtë vit përkrahja për bletarët e ka arrit kulmin. Jo që ne kemi mbetë për 500 €, por pse me u nda fermeri i serrave. Ne vitin e kalum kemi aps shumë nveojë për përkrahje, sepse dora e shtetit neve nuk na përkrah, dmth niveli qendror nuk na subvencionon sepse duhen kritere të rënda për me qenë përfitues nga niveli qendror, gjithçka me forcat tona i bojmë. Dhe prej komunës qe dy vjet nuk jemi subvencionu.

Abduraman Bushi: Si sqarim, nuk është që kemi përkrahë vetëm bletarinë. Ju kujtoj se vitin e kalum e kemi përkrahë lavërtarinë. Ndërsa sivjet, kemi përkrahë pemtarinë me 3500 fidane, do ta përkrahim blegtorinë me rotokosa. Krejt sektorët jemi tu i përfshi në përkrahje. Edhe për serrat, e kemi tash projektin me motokultivator, ku përfitojnë edhe fermerët e serrave, sepse siç e thashe dhe ma herët, du me i pajisë fermerët që mos me punu mo punë fizike, por gjithçka me pajisje moderne.

Zuli Kalisi: Po bohen gati 8 vjetë s'kam amrrë asnjë ndihmë e asnjë subvencion, shembull kanë përfitu 5 rrobaqepësi, krejt kanë marrë, unë s'kam marrë. Një ankesë vetëm tek pjesa e ndriçimit kah pjesa ku jetoj kah kufini.

Kushtrim Loki: Siç e dini, ne vitin e kalum jemi godit prej breshërit, dhe ka shkatërru gjithçka, dhe nuk po shoh që është planifiku diçka për raste të jashtzakonshme apo emergjente, dhe për dëmet nga breshëri, as nga komuna e as nga qeveria nuk kemi kompenzu diçka.

Sevdi Dernjani: Ne për çështjen e emergjencave e kemi të ndarë një shumë prej 15 mijë euro, mirëpo lidhur me dëmet e breshërit, është themelu një komision nga Komuna që i ka evidentu dëmet, dhe të njëjtat janë dërguar në Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave dhe tani mbetet tek ata për me i procesu evidentimet në Qeveri dhe ata mandej me i kompenzu dëmet.

Lindita Ballazhi: Siç e ceku edhe nënkryetari, ne e kemi të dnanë një shumë për emergjenca, është për sektor tjetër, por që për fatkeqësitë natyrore ne nuk kemi kompetenca për të planifikuar buxhet, dhe menaxhohen vetëm nga niveli qendror, ku edhe tek dëmet e breshërit janë dërgu lëndët në institucionet përkatëse, dhe prej tyre akoma s'ka diçka kompenzim.

Sevdi Dernjani: Shumë e kuptueshme si çështje, kjo është edhe qëllimi i dëgjimeve, që me u paraqit kërkesat por edhe pakënaqësitë në mënyrë që me u përfshi kërkesat tuaja në buxhetim, dhe pëmes kësaj ne si institucion mos me i përsërit gabimet që po supozohen që kanë ndodh gjatë këtij viti. Dhe DBPZHR duhet pasur parasysh që gjatë vitit 2026 me u përfshi në subvencionim edhe fermerët e serrave apo kulturave tjera.

Fesja Thaçi: Jam nga fshati Krevenik dhe mirrem me bletari. Kërkesa ime është me u dërgu shtyllat e rrymës deri tek tokat që ne i punojmë ose kemi bletët. Poashtu te ajo rrugë që osht tu u asfaltu, besoj se u dashtë me u fillu prej anej kah punohet toka e jo mbrapsht te pjesa kah ka fillu aty shfrytëzohet për shëtitje, u dashtë me pas parasysh me ushtru fillimisht kah ne që i punojmë tokat, kh ne që shfrytëzohet ma shumë.

Sevdi Dernjani: Besoj se kjo pjesa e rrugës se kah u dashtë e fillu mas pari, si me pas fillu rrugën kah Kreveniku, si nga Goranca, prapë se prapë do të kishte pakënaqësi. Kur e kemi dërgu projektin në Ministri, i cili ka vlerë rreth 1.1 milion euro, dhe e kemi përfitu si bashkëfinancim, plani ka qenë që krejt rruga me fillu me u shtru njëtrajtësisht, mirëpo ky projekt është me faza, e mira është që ky projekt ka hy në listë të realizimit, tash për fazën tjetër është shpallë fituesi i tenderit dhe ka mbetë nënshkrimi i kontratës dhe ndoshta deri në fund vit ose disa muaj me prit që me u realizu. Besoj se kur është prit 25 vjet me u realizu, tash ka mbetë me pas durim pak kohë diku 6 muaj apo një vit dhe me u realizu. Ndërsa sa i përket shtyllave, kam pas takim me drejtorin gjeneral të KEDS-it dhe një punë që ka fillu në fshatin Krevenik për vendosjen e shtyllave, ajo punë ka me përfundu qet javë. Ka pas disa defekte të vogla për disa shtylla që me u zhvendosë, por pika e parë është që shtyllat e betonit veçse janë vendosë në fshatin Krevenik. Dhe kërkesa tjetër që me u vendosë shtylla deri te vendi konkret, ne mudnemi me e marrë si

sugjerim, dhe në bashkëinvestim me KEDS-in, mundemi me intervenu, por nuk është e drejta e komunës ekskluzive që me vendosë shtylla.

Servet Suma: Unë po shoh tek kategoria e investimeve kapitale shumë projekte që përfshijnë rregullimin e trotuareve apo kanalizimeve në Han të Elezit. Si ide apo projekt e kisha pas që pse ne si Han i Elezit mos me pas një pikë grumbullimi të ujit me ramje të lirë me i vadit parqet e Hanit të Elezit. Gjithashtu Sharrcemi ka një sasi të konsiderueshme të ujit që nuk e shfrytëzon, te mergeli atje, dhe mundet një kërkesë Sharrcemit me e bo një projekt konkret që qajo sasi e ujit me u shfrytëzu në mënyrë efektive. Ktu hyn edhe që me pas një sistem me e marrë ujin edhe prej Lepencit vetëm për ujitje, shembul, parqet, oborret e shkollave, drunjtë e mbjellur deri te kufini, etj. Ndërsa tek çështja me pajisje bujqësore, unë kam një propozim që me investim publiko privat, me e ble një kombaj për korrijen e grunajave, ku tek disa fermerë shumë me vonesë është korre gruri dhe me një kombaj të ri me pas korrije shirje efikase.

Demir Thaçi: Jam nga fshati Krevenik dhe për Krevenik kisha pas një kërkesë, ku dy rrugia të vogla kanë mbetë pa u shtru me kubëza, ku mbi 10 herë kam bo këtë kërkesë edhe në mandatet e kaluara, por deri sot nuk janë rregullu. Njëra rrugë është te përfundimi tek rr.Baki Krasniqi që shkon te shtalla e Refik Qajanit, dhe tjetra rrugë është para shtëpisë time, ku disa edhe oborret i kanë të shtrume, e unë as në hymje të rrugës nuk kam, ku gjatë dimrit dhe shiut kam probleme me kalu edhe në shpi.

Sevdi Dernjani: Do t'i kemi parasysh edhe propozimet e Servetit dhe të Demirit.


Murat Loku: Në Han të Elezit kemi fermerë që rrisin krerë lopësh, që kanë nashta 15-20 krerë dhe kur mbledhet sasi e madhe e qumështit, ku me e çu atë sasi që mos me u prish. Si dhe te caktimi i numrit të bletëve për përfitim, a ka mundësi me u zvogëlu numri?

Abduraman Bushi: Caktimin e numrit të bletëve për me fitu të drejtën e subvencionimit e bën Ministria, dhe numri është 30 copa e mbi. Ne si kërkesë në Ministri mundemi me e bo, por ky është kriter i Ministrisë.

Sevdi Dernjani: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Nënkryetari i Komunës
Sevdi Dernjani

